

NJË PROBLEM I BESUESHMËRISË SË MATJEVE APO NJË PROBLEM I NATYRËS SË PROFILIT VLOROR PËR AKTORËT SOCIALË? (Rasti i një studimi panel vertikal për profilin vleror të elektoratit të qytetit të Tiranës. 2003-2008-2011)

ALEKSANDËR KOCANI
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

AKTET V, 4: 531 - 536, 2012

HYRJE

Kjo kumtesë synon që të paraqesë analizën, interpretimin dhe përfundimet që dalin prej një studimi të kryer nga një ekip studimor i Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës në vitet 2003, 2008 dhe 2011. Studimi është i tipit eksperiment panel “vertikal”. Domethënë, ngrihet si vijimësi e tre eksperimenteve të bazuara në anketime të tipit masiv, sasior të kryera me votues (në një rast edhe me studentë) të qytetit të Tiranës gjatë viteve 2003, 2008 dhe 2011. Anketimet në fjalë synonin që të testonin empirikisht një model mbi natyrën e profilin vleror të elektoratit të qytetit të Tiranës.

Kërkimet e mëparshme për tipin e sistemit vleror që karakterizonte shoqërinë shqiptare në periudhën e tranzicionit, natyrshëm përgatitën terrenin për të hulumtuar më thellë në natyrën e këtij sistemi dhe në shtrimin e problemit në se ka një sistem apo profil vleror si tipar të qenësishëm për aktorët socialë të kësaj shoqërie. Këtu rasti e solli që, **si nxitje** për të formuluar këtë problem⁸, shërbeu një kundërshtim që i bënin rezultateve të matjeve vlerore të Ronald Inglehartit dy studjues të tjerë, C.Brooks dhe J.Manza. Ata, në

thelb, pretendonin se po të përsëriteshin anketimet e kryera nga Inglehart me pak ndryshime të vogla, do të gjendeshin rezultate të kundërta më ato të nxjerra nga ai. Një kundërshtim i tillë në rafshin e logjikës formale nxirrte një problem, sepse shkelej kërkesa e moskontradikcionit logjik (për të njëjtën gjë, në të njëjtin drejtim bëheshin dy pohime të kundërta). Si përpjekje për të zgjidhur këtë problem u ndërtuan modelet e tipit *supozim përshkrues* që shërbyen si bazë për studimet eksperimentale të lartëpërmendura.

Eksperimentet e kryera në vitet 2003 – 2011, u bazuan në anketime masive me 300 – 500 respondentë që u përkisnin zonave elektorale të qytetit të Tiranës dhe u zhvilluan brenda një periudhe kohore një javore. Studentët që realizuan anketimin u trajnuan teorikisht dhe praktikisht. Në linjën teorike u paraqit problemi bazë dhe zgjidhjet e supozuara në trajtë modeli me të cilat ishte operuar në eksperimentet e mëparshme. Madje studentët në dy eksperimentet e fundit, paraprakisht janë vënë të ushtrohen vetë në formulimin e supozimeve bazë që përshkruanin profilin e mundshëm vleror të aktorëve socialë votues të qytetit të Tiranës, në nxjerrjen e implikimeve përkatëse dhe në skicimin e pyetësorit që do të përdorej për testimin empirik të këtyre supozimeve bazë. Kurse trajnimi praktik konsistonte në dhënien e elementeve kryesore të teknikave të intervistimit

⁸ Por, natyrisht problemi mund të formulohej edhe pa këtë nxitje specifike. Kështu, tek ai mund të vihej edhe duke reflektuar në mënyrë kritike mbi konceptin e qenies unike të Parmenidit, apo mbi konceptin dihotomik të thelbit të qenies të parashtruar nga Bachelard.

dhe në simulimin praktik të intervistimeve që ata do të kryenin në kuadrin e anketimit.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Modeli i profilit vleror

Studimi panel mbi natyrën e profilit vleror të aktorëve socialë të qytetit të Tiranës (2003 – 2011), thekson se si një nxitje specifike për të ndërmarrë atë studim ka shërbyer propozimi alternativ që japin C.Brooks dhe J.Manza⁹ ndaj modeleve vlerore shpjegues të dhëna kryesisht nga R.Inglehart¹⁰, një nga korifejtë e studimeve ne fushën e vlerave. Çështja është se, në thelb, rezulton që koncepti i Inglehart bazohet në supozimin primordial të ekzistencës, veçanërisht tek individit, por edhe më tej, te grupi social dhe shoqëria në tërësi, të një profili apo të një sistemi vleror të caktuar që ka “ngjyrim”, të themi, ose “materialist”, ose “postmaterialist”¹¹. Ndërsa Brooks dhe Manza pretendojnë se, në se do të përsëriteshin anketimet e Inglehart me metoda të tjera, në më të shumtën e rasteve të njëjtë respondentë do të konstatoheshin vlera të kundërta me ato që kishte raportuar Inglehart.

Mund të supozohet se ka një dallim thelbësor në këndvështrimin e thellë filozofik të konceptimit të natyrës së një profili vleror të aktorëve të ndryshëm socialë në shoqëri midis tyre dhe Inglehart. Pra, kemi dy konceptime dhe, përkatësisht, dy modele të kundërta lidhur me profilin vleror të aktorëve socialë. Sipas njërit, atij njëjësor, ka vetëm një profil vleror që karakterizon sistemin vleror përcaktues të një aktori social. Ky profil mund të jetë i tipit “materialist” (“të mbijetesës”), ose “post materialist” (“të vet afirmimit”)¹². Kurse për

konceptimin tjetër, ose nuk ka fare ndonjë profil vleror (hipoteza e e“mishellës” vlerore që formësohet në sistem vleror gjatë bashkëveprimit subjekt – objekt i njohjes), ose brenda aktorëve sociale ka një strukturë vlerore dyjare (e ngjashme me letrat e bixhozit) dhe bashkëveprimi subjekt-objekt i njohjes sipas rastit (tipit të pyetësorit) nxjerr në pah apo përzgjedh herë profilin “materialist” (“të mbijetesës”), dhe herë atë “post materialist” (“të vet afirmimit”).

Nga studimi panel mbi natyrën e profilit vleror të elektoratit të qytetit të Tiranës në dy eksperimentet e para (2003 dhe 2008), raportohej se më shumë kishte të ngjarë që të jetë rezultativ modeli unitar i profilit vleror. Domethënë, që aktori social karakterizohet vetëm nga një tip i profilit vleror, ndonëse ai mund të shfaqë edhe vlera të veçanta që i përkasin profilit të kundërt. Prandaj dhe synimi për të shqyrtuar për herë të tretë natyrën e profilit vleror të aktorëve socialë në vendin tonë dilte i përligjur.

Procedime praktike

Atëhere praktikisht në funksion të matjeve u konsiderua si më e përshtatshme që si model pune për studimin, apo supozim i dalë si implikim nga modeli bazë i studimit mbi natyrën ose dyjare, ose sinkretike të këtij profili vleror, të merret parashtimi:

*Duke krahasuar supozimet e kundërta mbi natyrën njëjësore apo jo njëjësore të profilit vleror të aktorëve socialë të shoqërisë së sotme shqiptare, ka më shumë të ngjarë që ajo e karakterit **jonjësor** t'i përgjigjet më mirë natyrës së këtij profili¹³.*

Në se do të ishte kështu, pra në se profili vleror, të themi i individit në shoqërinë e sotme shqiptare¹⁴ nuk do të ishte i tipit unikal, atëhere

⁹ Që hedhin idenë se, po të përsëriten anketimet e R.Inglehart me metoda të tjera, do të konstatohet që në shumicën e rasteve tek i njëjti person ka një përzjerje të vlerave materialiste me ato postmaterialiste. *Raisons de vivre. Raisons d'agir*, p.32, Sciences Humaines, No 79, 1998.

¹⁰ Në një sërë monografishë apo artikujsh të shkruajtura vetëm apo me bashkautorë të tjerë.

¹¹ Natyrisht këtu nuk përjashtohen edhe grupe të vlerave të kundërta, por jo të organizuara si sistem, si profil vleror të aktorëve socialë.

¹² Këtu është marrë në konsideratë vetëm dimensionin vlera materialiste/post materialiste dhe jo ai i vlerave tradicionale/shekullare.

¹³ U ndoq linja udhëzuese metodologjike popperiane e synimit të përgënjeshtimit të modelit për t'u testuar.

¹⁴ Faktori që lidhet me qenien e shoqërisë së sotme shqiptare dhe elementët përkatës të periudhës së tranzicionit, supozohet se do të ndikonte në tipin e modelit vleror unikal, në se pranohet si e mirëqënë hipoteza e Inglehartit. Gjykojmë se nga pikëpamja e pranimit të modelit bazë të studimit ky faktor mund të ketë vetëm një peshë sasiore, por jo cilësore në përvijimin e elementëve të profilit vleror të aktorëve

do të ishte e mundur që të ushtroheshin ndikime të tilla që të përcaktonin apo formësonin vetë këtë profil. *Nga pikëpamja statistikore*, kjo do të thonte që përgjigjet e dy pyetjeve në thelb të njëjta, por të ndërtuara njëra sipas strategjisë së ndikimit formësues dhe tjetra sipas metodologjisë së zakonshme, e cila përpiket të minimizojë në maksimum ndikimet edhe nëpërmjet pyetjeve, ***nuk do të shoqëroheshin në mënyrë domethënëse statistikisht.***

Që këndeje mund të deduktohej si implikim i drejtpërdrejtë i testueshëm empirikisht parashtrimi si vijon:

Po qe i vërtetë supozimi *se ka më shumë të ngjarë që profili vleror i aktorëve socialë të ketë karakter ionjëiësor, atëherë ka vend implikimi se: në se krahasohen përgjigjet ndaj pyetjeve në thelb të njëjta, por të formuluar sipas pikësynimit metodologjik të ndikimit në drejtimin e supozuar dhe atyre të formuluar jashtë këtij pikësynimi, do të duhej të pritej që midis këtyre përgjigjeve të mos ketë relacion të shoqërimit statistikor domethënës.*

Si implikimi, ashtu edhe supozimi bazë i lartëpërmëndur mund të testoheshin duke ndjekur linjën metodologjike të testimit të propozuar nga K.Popper, domethënë duke u përpjekur që të hidheshin poshtë apo të përgënjeshtroheshin ato. Më konkretisht u operua drejtpërsëdrejti me implikimin dhe në bazë të rezultateve pozitive apo negative të përpjekjeve për ta hedhur poshtë atë, u gjykua për fatin e supozimit bazë. Pritej që, nëse nuk do të arrihej që të përgënjeshtroheshin ato, atëherë do të ishim të detyruar që të pohonim se hë për hë implikimi dhe supozimi në fjalë nuk janë

socialë. Për arsye objektive testi i supozimit është bërë me një kampionim të zgjedhur nga qyteti i Tiranës, por **mendojmë** se kjo nuk e çënon rezultatin, qoftë se popullata e këtij qyteti është afro 1/3 e asaj të vendit, qoftë se ajo përfaqëson pak a shumë diversitetin subkulturor të zonave të ndryshme të vendit. Natyrisht që ka vend për diskutim në se rezultatet e këtij studimi do të mund të pranohej të shtriheshin në përmasat dhe përtej atyre të shoqërisë së sotme shqiptare. Por kjo është një çështje që i takon komunitetit shkencor ta zgjidhë.

hedhur poshtë dhe po kalojnë sprovat e tyre empirike.

Në përzgjedhjen e të gjitha pyetjeve, përfshirë këtu edhe ato që do të formonin çiftet, të cilat do t'i nënshtroheshin matjeve në kuadrin e testit të supozimit bazë të studimit, u konsiderua kuptimi operacionalist i koncepteve "sistem materialist i vlerave" dhe "sistem postmaterialist i vlerave"¹⁵ i bazuar në tabelat me indikatorë të dhëna nga R.Inglehart në punimin e tij "Modernization, cultural change, and the persistence of traditional values"¹⁶.

Në kuadrin e studimit u gjykua se ishte e vështirë që të bëhej një përcaktim operacionalist për sinkretizmin vleror dhe përcaktueshmërinë dyjare simetrike vlerore që lidhen me dy supozimet e lartëpërmëndura, i tillë që do të lejonte që nga matjet të dallonim se cilën prej këtyre vetive të pavarura po matnim. Ndryshe, ishte e vështirë që të identifikoheshin implikimet me supozimet përkatëse nga ku ato ishin deduktuar. Gjë që do të thotë se nuk mundej të gjykohej se kujt supozimi do t'i "faturuhej" në trajtë "të konvertuar" (duke interpretuar marrëdhien logjike midis implikimit dhe supozimit nga ai inferohet) "fatura" e testit negativ apo pozitiv të implikimeve të shqyrtuara në testin empirik (matjen). Kështu që, ajo që do të matej ishte në fakt një dallim i mundshëm midis të qenurit e vetisë së "unicitetit" (apo njëjesisë) të profilit vleror të qenies sociale dhe të mosqenurit të kësaj vetie, ku këtu futen si supozimi i sinkretizmit, ashtu edhe ai i profilit dyjar vleror. Pra, ekipi realizues i studimit mendoi se ishte në gjendje që të testonte apo maste dallimin midis supozimit që del logjikisht nga pikëpamja e Inglehart dhe alternativave të tjera që bien ndesh me atë. Pikësynimi ishte që ose të konfirmonte këtë supozim mbi profilin unik vleror, ose të pohonte mbi mundësinë e "hedhjes poshtë" (ose, më sakt, e lënies mënjanë si të papërshtatshëm) të tij. Në se do të kishte vend kjo mundësi e

¹⁵ Apo ekuivalentët e tyre që lidhen me vlerat e mbijetesës dhe ato të vetëafirmimit.

¹⁶ R.Inglehart, W.E.Baker, *Modernization, cultural change, and the persistence of traditional values*, American Sociological Review, 2000, Vol. 65 (February): 27).

fundit, studimi nuk do të ishte në gjendje që të vlerësonte si të konfirmuar konkretisht ndonjërin prej prej dy alternativave që bien ndesh me konceptin e profilit vleror unitar. Me një fjalë, studimi do të merrte përsipër vetëm të jepte një përfundim mbi mundësinë e konfirmimit, ose të hedhjes poshtë të supozimit që del logjikisht nga pikëpamja e Inglehart se aktori social (individ, grupi social etj.) **ka vetëm një profil vleror**, qoftë ky materialist (apo i mbijetesës), ose postmaterialist (apo i vetafirmimit).

Në këtë optikë epistemologjike, si objektiv apo fokus të metodologjisë së studimit u përcaktua që nëpërmjet teknikave të ndërtimit të pyetjeve dhe pyetësorit të hartoheshin dy blloqe të mëdha pyetjesh në thelb identike, por të konceptuara e realizuara në kuadrin e pikësnyimeve të kundërta. Njëri do të ndiqte parimet e zakonshme metodologjike të hartimit të pyetjeve dhe kombinimit të tyre, duke u përpjekur, midis të tjerave, që të minimizonte sa më shumë që të ishte e mundur ndikimin e intervistuesit dhe të pyetësorit tek respondentët. Kjo ishte linja e zakonshme që kishte ndjekur edhe Inglehart në anketimet e tija, të cilat konfirmonin logjikisht profilin unitar vleror të qenies sociale. Ndërsa blloku tjetër i pyetjeve u ndërtua me pikësnyimin, jo të zakonshëm nga pikëpamja metodologjike tradicionale, e ndikimit maksimal të mundshëm tek respondentit me anën e pyetjeve dhe të intervistuesve në një drejtim të përcaktuar nga modeli bazë. Ndikimi me anë të pyetjeve u synua me futjen e një shpjegimi kontekstual parahyrës në pyetje, i cili, në thelb sqaronte pozicionin që mbajnë qytetarët europiano-perëndimor ndaj problemit që shtronte pyetja. Njëkohësisht studentët intervistues u trajnuan që në mënyrë të unifikuar të jepnin intonacionin përkatës theksues në përputhje me fjalët e bolduara në shpjegimin hyrës të lartëpërmëndur. Pra, u synua që të bëhej maksimumi për të ndikuar tek respondentët sipas linjës që jepte ky shpjegim hyrës. Llogaria ishte bërë në disa asociacione të mundshme midis mënyrës si i konceptojnë gjërat qytetarët europiano-perëndimor, dëshirës së individëve shqiptarë për t'u integruar në Europë dhe pasojës që implikohej nga kjo dëshirë për të

adoptuar qëndrimet e qytetarëve europiano-perëndimorë. Këto do të përbënin ato që quhen supozime ndihmëse dhe që do të llogariteshin kur të kërkohej të interpretoheshin rezultatet e testit empirik të implikimeve në kuadrin e një gjykimi për supozimin bazë. Në veçanti, në se rezultati i mundshëm i testit empirik të implikimeve të "konvertuara" në dy blloqet e kundërta të pyetjeve të lartëpërmëndura do të ishte negativ, do të shtrohej pyetja se kujt do t'i "faturuhej" ky negativitet: supozimit bazë, apo ndonjerit prej spozimeve ndihmëse në fjalë (natyrisht në se ka bindje se janë realizuar kushtet e vëzhgimit).

Siç u theksua edhe më lartë, për hartimin e pyetjeve në të dy blloqet u morën parasysh indikatorët që jep Inglehart për sistemin materialist, apo të mbijetesës dhe atë postmaterialist, apo të vetafirmimit¹⁷.

Në hartimin e dy blloqeve të pyetjeve u tregua kujdes që të shmangen në maksimum ndikimet që lidhen me faktorë të tjerë nga ata të "piketuar" nga supozimi në testim. Kështu u bënë përpjekje që të shmangen, për shëmbull, të ashtuquajturat "efektet të renditjes" apo ato të "prirjes" që shfaqen gjatë ndërtimit të pyetësorëve, të cilat nuk i shërbenin testimit të supozimit të studimit. Për këtë u alternuan mënyrat e strukturimit të përgjigjeve me shkallëzim kur kishte pyetje që ishin të afërta në vendosje dhe në tematikë. Natyrisht që edhe në bllokun e pyetjeve me objektiv ndikimin në linjën e supozimit bazë, ku dhe u muarrën masat përkatëse që të shmangeshin sa të ishte e mundur ndikimet e llojeve të tjera, në përpunimin e përgjigjeve u përdorën teknika unifikuese (në renditjen dhe klasifikimin e kategorive të vetive të matura) që lejonin të bëheshin krahasime për të nxjerrë përfundime lidhur me shoqërimet statistikore të mundshme

¹⁷ Në pamundësi për të disponuar ndonjë nga monografitë e tij në formë libri, jemi mbështetur kryesisht në dy artikuj të botuar kohët e fundit në *Washington Quarterly* - « Globalization and Postmodern Values » 23.1 (2000) dhe në *American Sociological Review* - « Modernization, Cultural Change, and the Persistence of Traditional Values », 2000, Vol.65 (February:19-51), në këtë të fundit bashkautor me Wayne E. Baker.

midis tyre. Domethënë, u ndërtuan kollona shtesë me të dhëna ku renditja dhe klasifikimi i përgjigjeve të ishte identik nga pikëpamja e kategorive të variablave. Kjo në funksion të kontrollit të gabimeve të mundshme sidomos në përpunimin statistikor.

Në këtë mënyrë, nëse do të kishte ndikim, më e shumta ai do t'i kushtohej përpjekjes sonë për t'i ndikuar respondentët në drejtimin e përshtatjes me qëndrimet e ngjashme me ato të qytetarëve europiano-perëndimorë, gjë që ishte në përputhje me pikësynimin metodologjik të studimit. Gjithshka më lartë u theksua për vetë veçorinë e këtij studimi, i cili përfshinte si një komponent shumë të rëndësishëm të testimit edhe një mundësi për t'i ndikuar respondentët në një drejtim mjaft të përcaktuar, nëpërmjet të cilës do të merrej një vendim lidhur me pranimin ose jo të supozimit të lartëpërmëndur mbi profilin vleror njëjësor të aktorit apo qenies sociale.

Për kampionimin u përdor metoda e "bistakut" në përcaktimin e zonave dhe rrugëve, e kombinuar me stratet e papeshuara dhe kuotat sipas grupmohës dhe gjinisë brenda tyre.

Një element i rëndësishëm metodologjik i matjeve ishte përcaktimi i tipit të pyetjeve, i cili do të ishte në thelb i njëjtë në të dy blloqet dhe që do të paraqitej në njërin bllok në mënyrë të zakonshme, domethënë duke ndjekur kriteret e zakonshme metodologjike të hartimit të pyetjeve dhe pyetësorit. Ndërsa në bllokun tjetër formulimi i tyre u modifikua në mënyrë të tillë që t'i shërbente linjës së ndikimit të supozimit bazë dhe në përputhje me shpjegimin ndikues parahyrës për çdo pyetje. Sipas kriterëve të zakonshme metodologjike të hartimit të pyetësorëve u përfshinë edhe pyetje që do të kontrollonin shkallën e sinqeritetit të përgjigjeve të respondentëve. Kështu, në pyetësorët që u përdorën në tre anketimet, ishin rreth **20-22** çifte pyetjesh në thelb të njëjta, që ndryshonin në formë nga pasja ose mospasja e linjës së ndikimit që do testohej nga anketimi. Këto pyetje u përzgjedhën konkretisht në bazë të gjykimit se përmbajtja e tyre, më shumë se ajo e pyetjeve të tjera të zgjedhura në pyetësor, lejonte të vihej

më në dukje qartë një mundësi ndikimi të pyetjes në përgjigjen e dhënë nga respondentët. Në hartimin e tyre u llogarit që përgjigjet t'i përkisnin nivelit të variablit raport ose interval, nivel që lejon të gjykohet mbi varësitë e tipit të shoqërimit statistikor domethënës. Kështu u parashikua që, në se kishte vend supozimi i një ndikimi të orientuar në linjën e modelit bazë, **nuk** duhej të prisnim marrëdhënie të shoqërimit statistikor domethënës¹⁸ midis **20-22** çifteve të pyetjeve në fjalë. Po qe se do të rezultonte e kundërta, domethënë marrëdhënia e shoqërimit statistikor domethënës midis tyre, atëhere do të prananim që testi i implikimit ishte negativ dhe do të duhej të gjykohej për më tej se si do të vlerësohej modeli bazë. Rruga që do të ndiqej më konkretisht do të ishte që të ballafaqoheshin relacionet e dhëna nga tabelat e variablave të kryqëzuar, të përpunuara me programin SPSS-16, midis çdonjerit prej çifteve të lartëpërmëndur me përmbajtjen e pyetjeve përkatëse të përfshira në relacion. Për secilin çift do të nxirrej një përfundim dhe, më pastaj, do të merrej një vendim në përgjithësi lidhur me konsiderimin si pozitiv ose negativ të testit të implikimit të realizuar nëpërmjet matjeve sipas **20-22** indikatorëve të lartëpërmëndur.

Meqenëse modeli bazë i studimit në thelb **hedh poshtë** qenien e një profili vleror unik tek aktorët socialë në nivele të ndryshme, atëhere konstatimi i mundshëm i varësisë së shoqërimit statistikor domethënës midis variablave në çiftet e zgjedhura do të thonte që *ndikimi i supozuar në supozimin bazë ose nuk ekziston, ose është pa peshë*. Domethënë që midis këtyre variablave praktikisht ka varësi dhe, për rrjedhojë, bie poshtë implikimi që supozonte pavarësinë e tyre, e cila do të shfaqej si mungesë e shoqërimit statistikor domethënës midis vlerave të tyre. Pra, një mundësi e interpretimit do të ishte se testi empirik flet në të mirë të supozimit të natyrës **unike** të profilit vleror të aktorëve socialë.

¹⁸ Këtu, sigurisht ka probleme që lidhen sa me drejtimin, aq edhe me fortësinë e shoqërimeve statistikore të mundshme, të cilat kërkojnë interpretimin përkatës në përputhje edhe me përmbajtjen e pyetjeve tek të cilat hetohen këto shoqërimeve statistikore.

Domethënë, do të mund të shikohej si një konfirmim i supozimit që del logjikisht nga pikëpamja e Ronald Inglehartit. Natyrisht, e gjitha kjo do të kishte vlerë nga pikëpamja epistemologjike në se ne kemi garanci se, si në skemën logjike, ashtu edhe gjatë procedurës së realizimit praktik të testit empirik, nuk janë bërë gabime esenciale, me peshë që ndikojnë në ndryshimin e vlerësimit të rezultatit të këtij testi. Gjykojmë se në skemën logjike të realizimit të testit të supozimit bazë nuk ka ndonjë gabim të dukshëm. Ndërsa lidhur me sigurinë e ndjekjes me rigorozitet të metodologjisë së anketimit, çekimit, hedhjes së të dhënave në data base, këtu është e vështirë që të jepen garanci të plota. Në përputhje me metodologjinë e kërkimit, janë bërë monitorimi i çekimit dhe i hedhjes së të dhënave në data base dhe janë konstatuar gabime të vogla, të cilat janë korigjuar. Po ashtu janë bërë përpjekje maksimale që të monitorohej procesi i anketimit në terren.

REZULTATET DHE PËRFUNDIMET E STUDIMIT

Nga shqyrtimi i tabelave të kryqëzuara del se në dy eksperimentet e para **mbi 85%** e çifteve tregojnë shoqërim statistikor. Kurse për eksperimentin e tretë, ky marzh është **100%** e çifteve tregojnë shoqërim statistikor. Me që shkalla e domethënies (sinjifikancës) është tepër e lartë, e rendit nën **0,001**, mund të pranohet se midis çifteve në fjalë ka shoqërim statistikor domethënës tepër të pranueshëm.

Prandaj, është e pranueshme që të vlerësohet se çiftet në fjalë të pyetjeve të përzgjedhura për testimin e drejtpërdrejtë të supozimit shfaqin **marrëdhënien e shoqërimit statistikor domethënës**.

Kjo marrëdhënie e parë si një fakt empirik do të përbënte test negativ për implikimin e supozimit tonë: *Po qe i vërtetë supozimi se **ka më shumë të ngjarë që profili vleror i aktorëve socialë të ketë karakter jonjëësor, atëherë ka vend implikimi se: në se krahasohen përgjigjet ndaj pyetjeve në thelb të njëjta, por të formuluar sipas pikësnyimit metodologjik të ndikimit në drejtimin e supozuar dhe atyre të formuluar jashtë këtij pikësnyimi, do të duhej të pritej që midis këtyre përgjigjeve të mos ketë relacion të shoqërimit statistikor domethënës.***

Fakti që ne konstatojmë marrëdhënie të **shoqërimit statistikor domethënës** në të tre rastet e anketimeve, flet për një test negativ të përsëritur të implikimit të supozimit. Pra, ky implikim në vijimësi është hedhur poshtë. Çështja shtrohet në se do të mbartet ky negativitet edhe për vlerësimin e supozimit tonë. Meqënëse në të tre eksperimentet ne kemi konstatuar test negativ të implikimit në fjalë, na lind e drejta që të propozojmë që të konsiderohet si i **papranueshëm** supozimi ynë bazë. Kështu që mbetet **të pranohet** supozimi i modelit të **profilit vleror unitar** për aktorët socialë të qytetit të Tiranës.

BIBLIOGRAFIA

1. Bachelard G., *Le Nouvel Esprit Scientifique*, P.U.F., 1963.
2. Inglehart R., « Globalization and Postmodern Values », *Washington Quarterly* 23.1 (2000).
3. Inglehart R., Baker W.E., « Modernization, Cultural Change, and the Persistence of Traditional Values », *American Sociological Review* 2000, Vol.65 (February:19-51).
4. Lecomte J., *Raisons de vivre. Raisons d'agir*, p.32, Sciences Humaines, No 79, 1998.